



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:268763

Datë: 26.09.2022

Numri i dokumentit: 03459554

A.nr.257/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit B.. L. nga f., komuna e P., kundër të paditurit Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative me kërkesë për nxjerrjen e aktit administrativ, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 26.09.2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar padia e paditësit B.. L. nga f., komuna e P..
- II. URDHËROHET i padituri Komisioni Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, të merr aktvendim sipas kërkesës së paditëses të datës 06.02.2018 dhe vendimin t'ia dorëzoj paditësit sipas procedurës së përcaktuar me ligj.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt konform nenit 41 të LKA-së, me prani të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur të ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 20.02.2018 ka pohuar se i padituri nuk ka nxjerrë vendim sipas ankesës së tij për njohjen e statusit të Veteranit luftëtar të UÇK-së, andaj meqenëse janë plotësuar kushtet për heshtje administrative dhe duke pasë për qëllim mbrojtjen e të drejtave të tij, i propozon gjykatës që të nxjerr aktgjykim për njohjen e Statusit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së. Shton se me heshtjen administrative i është mohuar e drejta për korrigjimin e gabimit të lëshuar nga Komisioni kompetent për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi deklaroi: *“Mbetem në tërësi pranë padisë dhe thënieve në të, kërkoj nga gjykata mbi të gjitha dëshmitë që i posedon dhe deklaratat e tre komandantëve kompetent të aprovohet padia me të cilën të më njihet statusi siç parashihet në nenin 3 pargarfi 1.3.2 Veteran Luftëtar i UÇK-së”*.

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Gabime ka ndodh me rastin shqyrtimit të aplikacionit apo regjistrimit në shtabin e UÇK-së, sepse edhe në aplikacion kam sqaruar se nuk*

kam kontribuar në mbrojtjen civile por në pikën ku ishte udhëheqës i drejtpërdrejtë Fatmir Bllaca dhe Zeqir Berisha , andaj unë besoj se këtu është bërë gabimi dhe kam qenë i detyruar që këtë të drejtë ta kërkoj përmes padisë pasi që ankesa ime nga komisioni për këto kategori nuk e ka shqyrtuar dhe këtë dëshmi për ta bërë bindëse dhe të plotëfuqishme i kam sjellë edhe deklaratat nga komandantët kompetent me të cilët kemi qenë bashkë në luftën e UÇK-së, andaj gjykatës i propozoj që të aprovohet padia ime dhe të më njihet statusi i veteranit luftëtar i UÇK-së”.

E paditura në përgjigje në padi të datës 22.12.2020, ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar duke theksuar se Komisioni përkatës ka bërë raportimin përfundimtar Qeverisë me datën 20.05.2016 dhe se nga muaji Maj 2016 ka përfunduar procesin, andaj e paditura i propozon Gjykatës që padinë ta refuzoj si të pabazuar.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: kërkesa për rishqyrtim e dt.06.02.2018, dëftesa për pranim të dërgesës e dt. 07.02.2018, aplikacioni për njohje të statusit të veteranit i dt.27.02.2013, lista me kandidatët e refuzuar për njohje të statusit të veteranit, ankesa e dt.06.03.2015, deklaratat e I. R. e dt.06.02.2018, deklaratat e Z. B. e dt.03.02.2018, deklaratat e F. B. dt.03.02.2018, deklaratat e N. L. dt.03.02.2018, shkresa e zyrës së Kryeministrit e dt.02.03.2018, vërtetimi nga zona operative e Llapit e UÇK-së, dt.01.10.1999.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësit lidhur me institutin e heshtjes administrative dhe konstatoi se konform nenit 29 lidhur me nenin 46.6 të Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA), padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi tek e paditura me kohë kishte parashtruar kërkesën për rishqyrtim të ankesës së tij të dorëzuar me datë 06.03.2015 me numër protokollit S.431 drejtuar Komisionit Qeveritar, por që i padituri nuk ka marrë vendim për kërkesën e paditësit. Mbi bazën e kësaj situatë juridike, gjykata vlerësoi se paditësi me të drejtë ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit, për shkak të heshtjes së administratës, meqenëse marrja e vendimit sipas kërkesës së paraqitur dhe dorëzimi i tij palës në procedurë, është obligim i organit të paditur.

Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata konstatoi se në këtë çështje administrative-juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit, andaj organi i paditur do të ketë parasysht theksimet nga kërkesa e paditësit, dhe të marrë Vendim lidhur me kërkesën e paditëses.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5, 6, 29 dhe 38 si dhe Nenit 46, paragrafi 6 të LKA-së, gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.257/18, datë: 26.09.2022

Gj y q t a r i

Numri i lëndës: 2019:268763
Datë: 26.09.2022
Numri i dokumentit: 03459554

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj Gjykate.